



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISE

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA  
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF  
EDUCATION  
SCIENCE &  
TECHNOLOGY

NUMËR: 9/2009

DATA: 27.05.2009

## **UDHËZIM ADMINISTRATIV “KRITERET PËR PROVIMIN E MATURËS”**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Ligjit për provimin përfundimtar dhe maturës shtetërore dhe me nenin 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë:

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është që të përcaktojë kriteret e përgjithshme për hyrjen në provimin e maturës, duke përfshirë edhe kriteret e kalueshmërisë për nxënësit që kanë të drejtë të mbajnë këtë provim.

### **Neni 2 Kriteret për hyrje në provimin e maturës**

- 1.** Nxënësit që kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit të maturës duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:
  - 1.1.** Të ketë kryer me sukses klasën përfundimtare të arsimit të mesëm ashtu siç është paraparë me ligj;
  - 1.2.** Të jetë regjistruar për provimin e maturës pranë shkollës përkatëse;
  - 1.3.** Të ketë bërë pagesën përkatëse, ashtu siç përcaktohet nga KQSHM;
  - 1.4.** Të ketë dokumentin e vlefshëm të identifikimit, letërnjoftim ose pasaportë.

Nxënësit e arsimit profesional, përveç kritereve të parapara në paragrafin 1.1 të këtij neni, duhet të kenë kaluar me sukses provimin e brendshëm si pjesë e vlerësimit të brendshëm në shkollën përkatëse profesionale.

### **Neni 3** **Kriteret për nxënësit nga jashtë**

Nxënësit që kanë përfunduar me sukses shkollimin jashtë Republikës së Kosovës, dhe të cilët dëshirojnë t'i nënshtrohen provimit të maturës në Republikën e Kosovës, për të pasur të drejtë të hyjnë në këtë provim, duhet të bëjnë edhe nostrifikimin e diplomës përkatëse, ashtu siç është përcaktuar me ligj.

### **Neni 4** **Mbarëvajtja e provimit të maturës**

1. Gjatë kohës së mbajtjes së provimit të maturës nxënësit duhet të respektojnë rendin dhe disiplinën, ashtu siç është përcaktuar me rregullat mbi administrimin e provimit të maturës.
2. Nxënësit që nuk respektojnë rregullat nga paragrafi (1) i këtij neni mund t'ju shqiptohen masat si në vijim:
  - 2.1. Vërejtje;
  - 2.2. Ndërprerje e provimit duke ia marrë testin para kohës, por duke ia konsideruar si të vlefshme punën e bërë deri në momentin e marrjes së testit;
  - 2.3. Anulim të testit dhe përjashtim nga provimi.

### **Neni 5** **Kriteret e kalueshmërisë dhe ankesat**

1. Për të kaluar provimin e maturës me sukses, nxënësit duhet të përgjigjen saktë në të paktën 50% të kërkesave të parashtruara në testin e tij, ashtu siç është paraparë me ligj.
2. Nxënësi që nuk arrin të plotësojë kërkesat nga paragrafi (1) i këtij neni, ka të drejtë t'i nënshtrohet provimit në ndonjërin nga afatet pasardhëse.
3. Nxënësi që nuk është i kënaqur me rezultatin, dhe ka dyshim të bazuar për paanshmërinë e vlerësimit të testit të tij, ka të drejtë të paraqesë ankesë brenda afatit të caktuar me ligj.
4. Nxënësi që paraqet ankesë sipas paragrafit (3) të këtij neni, mund t'i drejtohet Komisionit të posaçëm për ankesa pranë KQSHM.


5. Ndaj vendimit të marrë nga Komisioni i posaçëm i KQSHM-së, nxënësi mund të paraqesë ankesë në shkallë të dytë pranë Komisionit për ankesa të MASHT.

**Neni 6**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij U.A. shfuqizohen të gjitha dispozitat nënligjore të cilat janë në kundërshtim me këtë U.A.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.



Enver Hoxhaj ,ministër